




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-7774/23 datë:22.03.2023



Npi – 01/105 datë: 30.03.2023

Në bazë të nenit 12.2 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr.28/2008); Neni 58.3 të Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048; Neni 2.3 të Ligjit për Financat e Pushtetit Lokal Nr.03/L-049; Si dhe mbi bazën e prezantimit të pikës “Propozim-Vendimin për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual 2023, dhe rritja e kufirit të hyrave”, nga Zyra Kryesore Financiare, Kuvendi i Komunës, pas shumë diskutimeve, në mbledhjen e mbajtur më 30.03.2023, miratoi këtë:

V E N D I M

**PËR MOS MIRATIMIN E PROPOZIM-VENDIMIT PËR BARTJEN E BUXHETIT
TË PA SHPENZUAR NGA VITI I KALUAR NË VITIN AKTUAL 2023,
DHE RITJA E KUFIRIT TË HYRAVE**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes në mbledhjen e -III- të rregullt për vitin 2023, e mbajtur më: 30.03.2023, me 10 vota “Për”, me 11 vota “Kundër” dhe me 0 vota “Abstenim” nuk e miratoi Propozim-Vendimin për bartjen e buxhetit të pa shpenzuar nga viti i kaluar në vitin aktual 2023, dhe rritja e kufirit të hyrave.

II

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Zyrës për Financa, Drejtorive, Kryetarit të Komunës, Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesi i Kuvendit

Adnan Ademi